VENDIM
Nr. 690, datë 23.10.2019

PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË TË REDUKTUAR, TË SALLËS B, KATI 0, (*UNDERGROUND*) NË AMBIENTET E PALLATIT TË KONGRESEVE, KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës B, kati 0 (*underground*), me sipërfaqe 243 (dyqind e dyzet e tre) m^2, të ndodhur në ambientet e Pallatit të Kongreseve, Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, me qëllim zhvillimin e seancave dëgjimore.
2. Tarifa e qirasë së sallës B, kati 0 (*underground*) do të jetë në masën ekuivalente të shpenzimeve operative të kryera respektivisht për çdo aktivitet, gjatë gjithë periudhës së dhënies me qira.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama